



**Grupi Parlamentar  
i  
Lidhjes Demokratike të Kosovës  
në  
Kuvendin e Kosovës**

# **BULETINI I**

**Legjislatura e VI  
Sesioni vjeshtor 2017**

**Dhjetor 2017**

## Përmbajtja

1.	HYRJE .....	3
2.	ANGAZHIMI I GP-LDK NË SEANCAT PLENARE .....	3
2.1.	<i>Deklarimet jashtë rendit të ditës</i> .....	4
2.2.	<i>Pyetjet parlamentare</i> .....	4
2.3.	<i>Qëndrimet e GP-LDK lidhur me projektligjet e shqyrtuara në seancat plenare</i> .....	5
2.4.	<i>Interpelancat</i> .....	8
3.	ANGAZHIMI I GP-LDK NË KOMISIONE PARLAMENTARE .....	9
4.	NISMAT LIGJORE TË NDËRMARRA NGA GP-LDK .....	10
5.	ANGAZHIMI I GP-LDK NË ÇËSHTJE TË TJERA .....	10
6.	MBLEDHJET DHE PARAQITJET PUBLIKE TË GP-LDK .....	11
SHTOJCA 1	GP-LDK NË KUVENDIN E KOSOVËS NË LEGJISLATURËN E VI .....	12
SHTOJCA 2	PJESËMARRJA E GP-LDK NË KOMISIONE PARLAMENTARE .....	13
SHTOJCA 3	STAFI MBËSHTETËS I GP-LDK .....	15

## **1. HYRJE**

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (GP-LDK) në Legjislaturën e VI të Kuvendi të Kosovës përbëhet nga 27 deputetë (përfshirë këtu dy deputetë nga “Alternativa” sipas marrëveshjes parazgjedhore), prej të cilëve 9 janë femra. Lista e plotë e deputetëve mund të gjenden në Shtojcën 1.

Në Kryesinë e Kuvendit të Kosovës, GP-LDK përfaqësohet nga z.Kujtim Shala, Nënkryetar i Kuvendit të Kosovës, dhe nga z. Avdullah Hoti, Kryetar i GP-LDK.

Në këtë legjislaturë, GP-LDK udhëheq tre Komisione Parlamentare që konsiderohen më të rëndësishmit:

- (i) Komisioni për Buxhet dhe Financa,
- (ii) Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, dhe
- (iii) Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Në tre Komisione të tjera, GP-LDK e ka zëvendëskryetarin e parë të Komisionit:

- (i) Komisioni për Integriteteve Evropiane,
- (ii) Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, dhe
- (iii) Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Në këtë legjislaturë, GP-LDK i përket opozitës dhe si i tillë po luan rol kyç në Kuvendin e Kosovës, duke grupi kryesor opozitar me veprime opozitare të vendosura, përmbajtësore dhe konstruktive. Opozitarizmi i GP-LDK bazohet në filozofinë politike të LDK-së, si parti shtet formuese dhe institucionale. Veprimet opozitare janë gjithmonë në përputhje me interesat e qytetarëve dhe interesat shtetërore të Kosovës. Si i tillë, GP-LDK është duke u parë si gardiani më i rëndësishëm i interesave shtetërore në Kuvendin e Kosovës.

## **2. ANGAZHIMI I GP-LDK NË SEANCAT PLENARE**

Gjatë sesionit të parë vjeshtor të legjislaturës së VI të Kuvendit janë mbajtur 12 seanca plenare, prej të cilave 2 kanë qenë të jashtëzakonshme. Një seancë e jashtëzakonshme është kërkuar nga GP-LDK për të shqyrtuar orientimet programore të Qeverisë të dorëzuara në Kuvend me rastin e votimit të Qeverisë. Në seancat e rregullta janë shqyrtuar një numër i konsiderueshëm i projektligjeve dhe raporteve vjetore të institucioneve të pavarura që i përgjigjen Kuvendit të Kosovës.

Në të gjitha seancat, GP-LDK ka qenë shumë aktiv me diskutime dhe paraqitje të deputetëve. Rol aktiv ka luajtur në veçanti në seancat ku u shqyrtuan:

- Rishikimi i buxhetit për vitin 2017,
- Buxheti për vitin 2018 dhe
- Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021.

GP-LDK ka dhënë kontributin e vet edhe gjatë shqyrtimeve të raporteve vjetore të institucioneve të ndryshme:

- Raporti vjetor i Bankës Qendrore për vitin 2016,
- Raporti vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike për vitin 2016,
- Raporti vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016,
- Raporti vjetor i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2016.

### *2.1. Deklarimet jashtë rendit të ditës*

Në 12 seancat parlamentare të mbajtura gjatë sesionit vjeshtor të kësaj Legjislature, vetëm 4 herë ka qenë e paraparë koha për deklaratimet jashtë rendit të ditës. Në këto deklarime paraqiten çështje të cilat deputet apo grupet parlamentare konsiderojnë se duhet të bëhen publike në seancë.

GP-LDK ka pasur gjithsej 10 deklarime për çështjet si në vijim:

- |  |   |
|--|---|
| • Shpenzim i parasë publike/financa      | 3 |
| • Drejtësi                               | 2 |
| • Çështje sociale                        | 2 |
| • Arsim                                  | 1 |
| • Përmbushja e kritereve për liberalizim | 1 |
| • Dialogu Kosovë-Serbi                   | 1 |

### *2.2. Pyetjet parlamentare*

Deputetët e GP-LDK gjatë këtij sesioni kanë parashtruar gjithsej 35 pyetje parlamentare lidhur me çështjet si në vijim, që janë në përputhje me interesimet e qytetarëve të paraqitura nëpër të gjitha hulumtimet e opinionit publik:

- |  |   |
|--|---|
| • Ekonomi dhe punësim                  | 9 |
| • Shëndetësi                           | 5 |
| • Financa/paraja publike               | 4 |
| • Administratë publike                 | 4 |
| • Mirëqenie sociale dhe papunësi       | 4 |
| • Infrastrukturë                       | 2 |
| • Punë të brendshme dhe siguri publike | 2 |
| • Drejtësi, rend dhe ligj              | 1 |

- Arsim 1
- Forca e Sigurisë së Kosovës 1
- Mbrojtje e ambientit 1
- Çështje kulturore dhe të trashëgimisë 1

### **2.3. Qëndrimet e GP-LDK lidhur me projektligjet e shqyrtuara në seancat plenare**

Në seancat plenare janë diskutuar një sërë projektligjesh, marrëveshje ndërkombëtare dhe raporte të institucioneve të cilat i përgjigjen Kuvendit të Kosovës. Në vazhdim janë dhënë qëndrimet që ka mbajtur GP-LDK lidhur me këto çështje dhe arsyeshmërinë e qëndrimeve të tilla.

***Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2016 Kosovë-BE:*** Duke qenë se kjo marrëveshje është negociuar dhe përgatitur gjatë Qeverisë së udhëhequr nga ana e Kryetarit Mustafa, si dhe duke pasur parasysh rëndësinë e saj dhe partneritetin me BE, GP-LDK ka votuar pro.

***Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e vitit 2017:*** GP-LDK, pas shqyrtimit në detaje të Projektligjit për rishikimin e Buxhetit të vitit 2017, ka votuar kundër këtij projektligji me arsyetimin se me këtë rishikim dëmtohet struktura e buxhetit për vitin 2017 dhe shkurtohen disa nga projektet kyçe infrastrukture në Kosovë, siç është autostrada Prishtinë-Gjilan, heqja e Fondit për Sigurimet Shëndetësore, mos respektimi i Ligjit për Veteranët e Luftës etj.

***Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Lirinë Fetare në Kosovë:*** Në leximin e parë, GP-LDK ka votuar pro këtij projektligji, me mundësinë e amendamentimit të tij gjatë punës në Komisione. Amendamentet tek të cilat do të fokusohet GP-LDK kanë të bëjnë kryesisht me kriterin, mënyrën dhe kushtet e regjistrimit të bashkësive fetare, definimi i mënyrës së zgjedhjes së Komisionit i cili do të bëjë regjistrimin e bashkësive fetare, si dhe qartësimin e të drejtës së bashkësive fetare për të themeluar institucione edukative-arsimore.

***Projektligji për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën:*** Në leximin e parë, GP-LDK ka votuar pro, me mundësinë që gjatë punës në Komisione të amendamentohet ky projektligj duke pas parasysh çështjet si: harmonizim dhe dakordim me Ministrinë e Punëve të Brendshme lidhur me çështjet e sigurisë publike, qartësimi i dilemave lidhur me licencimin e institucioneve shëndetësore, qartësimi i mënyrës së themelimit të ndërmarrjeve publike komunale si dhe qartësimi i grantit shtesë për kryeqytet.

**Projektligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme:** GP-LDK ka votuar pro këtij projektligji në lexim të parë, duke pas parasysh se i njëjti është punuar në kohën kur me Qeverinë ka udhëhequr Kryeministri Mustafa si dhe rëndësinë e çështjeve që trajtohen në këtë projektligj, ku hyjnë si rregullimi në detale i procedurave të tatimit në pronë, përmirësimi cilësor i procesit të vlerësimit të pronave të paluajtshme si dhe përcaktimi i mekanizmave të rinj për mbledhjen e detyrimeve tatimore.

**Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Trashëgiminë në Kosovë:** Ky projektligj është përkrahur nga GP-LDK për dy arsye: zhvendosja e çështjes së trajtimit të trashëgimisë nga gjykata tek noterët si dhe trajtimi adekuat i trashëgimisë sa i përket barazisë gjinore.

**Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës:** GP-LDK e ka përkrahur në parim, me mundësinë që gjatë punës në Komisione të jap kontributin e vet me amendamentet e domosdoshme për fushën e cila kërkohet të ndryshohet.

**Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën jokontestimore:** GP-LDK e ka përkrahur në parim duke lënë të hapur mundësinë e amendamentimit të tij gjatë punës në Komisione. Përkrahja është dhënë mbi bazën se ku projektligj trajton zgjerimin e kompetencave të noterëve dhe në këtë mënyrë ligji i ri mundëson shkarkimin e gjykatave nga lëndët e shumta që po zvarriten me vite.

**Projektligji për Ndërmjetësim:** Është përkrahur nga GP-LDK duke qenë se u mundëson qytetarëve të shfrytëzojnë ndërmjetësimin si mundësi alternative në zgjidhjen e problemeve pa iu drejtuar gjykatave. Po ashtu, GP-LDK gjatë punës në komisione do të jap kontributin e vet në mënyrë që ky ligj të përmbush pritshmëritë e qytetarëve dhe bizneseve.

**Projektligji për shoqëritë tregtare:** Është përgatitur nga Qeveria paraprake e Kryeministrit Mustafa. Duke qenë se ky projektligj rregullon fushën e shoqërive tregtare, mbrojtjen e investitorëve të vegjël si dhe krijimin e numrit unik të biznesit për këto shoqëri, GP-LDK e ka përkrahur këtë projektligj në leximin e parë.

**Projektligji për standardizim:** Edhe ky projektligj është përgatitur nga ana e Qeverisë paraprake. Si një ndër ligjet që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe i cili krijon bazën e mirëfilltë ligjore për rritjen e nivelit të sigurisë së produkteve dhe shërbimeve, shfrytëzimin racional të materialeve dhe energjisë, si dhe zvogëlimin e barrierave teknike në tregti, GP-LDK e ka përkrahur këtë projektligj në lexim të parë.

**Projektligji për Noterinë:** Në parim GP-LDK e ka përkrahur këtë projektligj, duke lënë mundësinë që gjatë punës në komisione të jap kontributin e vet sidomos tek çështjet siç janë numri i noterëve, ushtrimi i profesionit, çmimet e shërbimeve e të tjera, në mënyrë që ky projektligj të arrijë nivelin e duhur që t'i shërbej profesionit të Noterisë.

**Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror:** Duke qenë se ky projektligj ka për qëllim përafrimin me Rregulloren e BE-së për krijimin e një Kodi të Unionit për rregullat për lëvizjen e personave përtej kufijve, të drejtave themelore të lëvizjes, vulat dhe vendosja e tyre, GP-LDK e ka përkrahur këtë projektligj në leximin e parë.

**Projektligji për Infrastrukturë kritike:** GP-LDK ka vlerësuar se projektligji për infrastrukturën kritike është i rëndësishëm së veçantë duke qenë se rregullon ruajtjen dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike kombëtare dhe evropiane, mbrojtjen e qytetarëve të Republikës së Kosovës, parandalimin e incidenteve dhe minimizimin e dëmit potencial për infrastrukturë kritike, ruajtjen e pasurisë së përgjithshme dhe çështje të tjera, si të tillë e ka përkrahur atë.

**Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018:** Pas analizimit në detaje në kuadër të GP-LDK, ky projektligj nuk ka marrë përkrahje pasi është vlerësuar se buxheti i vitit 2018 karakterizohet me:

- Përkeqësim të strukturës së buxhetit në dëm të investimeve kapitale,
- Parashikime ekonomike të pabazuara,
- Rritje minimale e të hyrave në tri vitet e ardhshme,
- Dëmtim i bizneseve dhe investimeve përmes një strukture jo adekuate të investimeve sipas sektorëve,
- Përgjysmim i normës së rritjes së eksporteve në tri vitet e ardhshme,
- Rritje e shpenzimeve rrjedhëse dhe zvogëlimi i atyre kapitale,
- Mos përfshirje e fondit për sigurime shëndetësore,
- Rritje e shpenzimeve për mallra/shpenzime për 17% pa arsyeshmëri etj.

GP-LDK ka paraqitur disa amendamente, të cilat do të kishin përmirësuar disa nga të metat e këtij buxheti, por të cilat nuk kanë marrë mbështetje në seancë. Ndërkaq, deputetët e GP-LDK kanë paraqitur dhjetëra amendamente individuale, kryesisht për projekte kapitale nëpër sektorë të ndryshëm. Në shumicën e rasteve këto amendamente janë aprovuar në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe në seancë.

**Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për financim shtesë për projekte për bujqësi dhe zhvillim rural ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim:** Pas shqyrtimit të projektligjit dhe

marrëveshjes dhe duke pasur parasysh se negociimi i kësaj marrëveshje është bërë në Qeverinë Mustafa, GP-LDK e ka përkrahur ratifikimin. Për më tepër marrëveshja në fjalë mundëson financimin e aktiviteteve në fushën e bujqësisë, dhe në veçanti rehabilitimin e rrjetit të ujitjes së tokave bujqësore në kuadër të sistemit të Radoniqit në Komunat Gjakovë, Rahovec dhe Prizren.

***Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për projektin e konkurrueshmërisë dhe gatishmërisë për eksport ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim:*** Duke qenë se kjo marrëveshje dhe ky projektligj janë punuar në kohën e Qeverisë Mustafa dhe lidhet me përmbushjen e objektivave të Agjendës të Reformave Evropiane, GP-LDK i ka dhënë mbështetje.

***Projektligji për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale:*** Ky projektligj e përaftron Kosovën me BE-në dhe si i tillë është përkrahur nga GP-LDK.

***Projektligji për Ndërmarrjet sociale:*** Projektligji ka për qëllim që të kontribuojë në zhvillimin e ekonomisë përmes krijimit të ndërmarrjeve sociale të cilat adresojnë çështje sociale, duke përfshirë punësimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe të mirave në interes të shoqërisë. Andaj GP-LDK e ka përkrahur, duke lënë mundësinë që i njëjti të avancohet edhe më tepër gjatë punës në komisione.

#### ***2.4. Interpelancat***

Një nga format demokratike të të bërit opozitë është edhe kërkesa për interpelancë për të shqyrtuar një çështje e cila lidhet me punën e Qeverisë ose të një Ministrie. Gjatë sesionit vjeshtor, GP-LDK ka parashtruar dy kërkesa për interpelancë ndaj Kryeministrit.

Interpelanca e parë është mbajtur me datë 3 tetor 2017, ku është kërkuar sqarim për akuzat publike për maltretim dhe torturim të qytetarëve shqiptarë, të ndodhur në vitet e paraluftës, të ngritura ndaj Ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Nenad Rikallo.

Ndërkaq, në interpelancën e dytë është kërkuar nga Kryeministri sqarim lidhur me sjelljen e pahijshme (gjuajtje me armë zjarri) të shfaqur në media të zv.Kryeministrit dhe Ministrit të Diasporës dhe Investimeve Strategjike z.Dardan Gashi. Kjo kërkesë është në procedura të Kuvendit.

Kërkesat për këto dy interpelanca janë bazuar në filozofinë e veprimit politik të LDK-së dhe parimin se institucionet e Republikës së Kosovës duhet të udhëhiqen nga njerëz me duar të pastra, nga njerëz që nuk kanë rënë ndesh me ligjin dhe aq



më pak, dhe asnjëherë, nga njerëz që akuzohen për dhunë e torturë ndaj qytetarëve të Kosovës.

### **3. ANGAZHIMI I GP-LDK NË KOMISIONE PARLAMENTARE**

GP-LDK në Legjislaturën e VI të Kuvendit të Kosovës udhëheq tre Komisione Parlamentare:

- Komisioni për Buxhet dhe Financa,
- Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike dhe
- Komisioni për Menaxhimin e Financave Publike.

Në tre Komisione të tjera, GP-LDK e ka zëvendëskryetarin e parë:

- Komisioni për Integriteteve Evropiane,
- Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, dhe
- Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Ndërkaq, në të gjitha Komisionet e tjera GP-LDK përfaqësohet me nga dy deputetë, përveç një komisioni.

Komisioni për Buxhet dhe Financa udhëhiqet nga z.Lumir Abdixhiku. Gjatë sesionit të parë vjeshtor, ky Komision ka mbajtur 11 takime në të cilat janë shqyrtuar një numër i konsiderueshëm i ligjeve dhe raporteve të ndryshme nga institucione të cilat i përgjigjen Kuvendit. Ndër çështjet kryesore të shqyrtuar nga ana e Komisionit për Buxhet dhe Financa janë projektligji për rishikimin e buxhetit për vitin 2017 si dhe projektligji për buxhetin e vitit 2018. Gjatë shqyrtimit të këtyre dy projektligjeve, deputetët e GP-LDK përmes amendamenteve kanë arritur të bëjnë ndryshimet e domosdoshme për të siguruar mirëqenien e qytetarëve të vendit si dhe për t'u kujdesur që paraja publike të shfrytëzohet në dobi të tyre.

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, i cili udhëhiqet nga znj.Vjosa Osmani-Sadriu, gjatë këtij sesioni ka mbajtur 7 takime në cilat janë shqyrtuar çështje me rëndësi të veçantë siç është Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, si edhe janë ndërmarrë hapa në përmirësimin e imazhit të Kosovës në botë siç është hartimi i planit për zhvillimin e diplomacisë parlamentare.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, i cili udhëhiqet nga z.Driton Selmanaj, ka mbajtur 6 takime gjatë këtij sesioni në të cilat ka shqyrtuar, ndër të tjera, këto çështje: Raporti vjetor të auditimit, Funkcionimin e Sistemit të

Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike si dhe Projektligjin për Kontroll të Brendshëm të Financave Publike. Pas katër vite stagnimi, ky Komision i ka përzgjedhur auditorët për auditimin e financave të partive politike për vitet 2013-2016. Deputetët e GP-LDK në këtë Komision janë të përkushtuar që të mbikëqyrin nga afër mënyrën e shpenzimit të parasë publike, menaxhimin efikas financiar etj.

#### **4. NISMAT LIGJORE TË NDËRMARRA NGA GP-LDK**

Gjatë sesionit vjeshtor, GP-LDK e ka iniciuar ndryshimin e dy ligjeve për të zbatuar masat e Pakos Fiskale 2, të miratuar nga Qeveria Mustafa më 17 korrik 2017. Këto nismat ligjore u ndërmorën për ta mbështetur biznesin privat dhe punësimin, duke parë se Qeveria aktuale nuk është e fokusuar në agjendën e zhvillimit ekonomik e as nuk ka dokument ku specifikohen reformat ekonomike që do të ndërmerren për të përmirësuar më tutje kushtet e të bërit biznes.

Pako Fiskale 2 përfshinë 22 masa. Për zbatimin e shumicës së masave, kërkohet ndryshimi i udhëzimeve administrative apo i rregullore të ministrive dhe të Qeverisë. Për zbatimin e masave 13 dhe 14 kërkohet ndryshimi i Ligjit për të Ardhurat e Korporatave dhe Ligjit për të Tatimin në Vlerën e Shtuar.

Sipas vlerësimeve të GP-LDK, këto ndryshime do të kenë efekte pozitive për:

- Mijëra bujq anembanë Kosovës, të cilët nuk do të kenë nevojë të paguajnë 3% të vlerës së produkteve që shesin tek grumbulluesit e produkteve bujqësorë.
- Kompanitë e sigurimit në Kosovë, të cilat kanë portfolio momentale shumë të ulët,
- Kompanitë e transportit ndërkombëtare të udhëtarëve, të cilat tani nuk do të kenë nevojë të kryejnë furnizimet jashtë Kosovës,
- Mbi 1,500 prodhues dhe përpunues të arit, si dhe qytetarët.

#### **5. ANGAZHIMI I GP-LDK NË ÇËSHTJE TË TJERA**

Në vijim janë paraqitur disa çështje specifike në të cilat është angazhuar GP-LDK:

- (i) GP-LDK ka qenë i vendosur që gjithmonë të respektohet Rregullorja e Punës të Kuvendit të Kosovës. Vlen të theksohet çështja e formimit të Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim. GP-LDK nuk është pajtuar me vendimin arbitrar të Kryetarit të Kuvendit, me të cilin vendim përbërja e këtij Komision nuk reflektonte madhësinë e Grupeve Parlamentare në Kuvend, si dhe kryesuesi i Komisionit nuk ishte caktuar sipas Rregullores të Punës të Kuvendit. Ky vendim u anulua dhe Kryesia

e Kuvendit nxori një vendim tjetër, i cili pjesërisht i adreson shqetësimet e GP-LDK. Tani me vendimin e ri përbërja e Komisionit merr parasysh madhësinë e Grupeve Parlamentare në Kuvend, por kryesuesi i Komisionit nuk është caktuar sipas Rregullores të Punës të Kuvendit. Kërkesa e GP-LDK është të respektohet plotësisht kjo rregullore në themelimin e këtij Komisioni të rëndësishëm.

- (ii) GP-LDK ka luajtur rol vendimtar që të kthehen 11 milion euro në Fondin për Shëndetësi, të cilat Qeveria aktuale kishte tentuar t'i destinojë në projekte të tjera. Këto mjete janë kthyer prapë në sektorin e shëndetësisë për shërim jashtë vendit dhe qëllime të tjera shëndetësore.
- (iii) GP-LDK ka kërkuar sjelljen me urgjencë të ligjit të arsimit të lartë për plotësim-ndryshim, duke ditur ngecjet e mëdha në reformën e këtij sektori të rëndësishëm për vendin, si dhe kemi ngritur zërin në leximin e parë të projektligjit të buxhetit për vitin 2018 për zvogëlimin për 40% të buxhetit për zhvillimin e mësimdhënies dhe kurrikulave, si dhe për shkarkimin jo të ligjshëm të Bordit të Këshillit të Lartë të Cilësisë.

## **6. MBLEDHJET DHE PARAQITJET PUBLIKE TË GP-LDK**

Gjatë kësaj legjislatore, GP-LDK ka mbajtur 17 takime të Grupit, në të cilat janë diskutuar: agjenda e seancave plenare, qëndrimet e GP-LDK në Komisionet Parlamentare, nismat legjislative të Grupit, qëndrimet politike, deklaratimet jashtë rendit të ditës dhe çështje të tjera.

Deputetët e GP-LDK kanë qenë mjaft prezent në media për të paraqitur qëndrimin e Grupit Parlamentar, si dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës, lidhur me çështjet në diskutim në Kuvendin e Kosovës. Në funksion të kësaj, GP-LDK ka mbajtur 9 konferenca për media për temat si në vijim:

- Qëndrimi i Grupit Parlamentar lidhur me shtyrjen e formimit të Qeverisë,
- Shkelja e Rregullores dhe proceduarve të Kuvendit,
- Interpelanca e Kryeministrit për rastin Rikallo,
- Reformat e të bërit biznes nga raporti i Bankës Botërore,
- Nisma ligjore për implementimin e Pakos Fiskale 2,
- Interpelanca e Kryeministrit për rastin e zv.Kryeministrit Gashi,
- Raporti i 100 ditëve të punës së Qeverisë,
- Mos pjesëmarrja e GP-LDK në adresimin vjetor të Presidentit në Kuvendin e Kosovës,
- Tendencat e në grupi të deputetëve për të shfuqizuar Ligjin për Gjykatën Speciale.

**SHTOJCA 1 GP-LDK NË KUVENDIN E KOSOVËS NË  
LEGJISLATURËN E VI**

Emri dhe Mbiemri	Nr. i tel	E-mail
1. Avdullah Hoti	045 148 888	avdullah.hoti@gmail.com
2. Vjosa Osmani-Sadriu	044 550 721	vjosao@yahoo.com
3. Driton Selmanaj	044 248 332	dritonselmanaj@gmail.com
4. Lumir Abdixhiku	044 333 577	lumirabdixhiku@gmail.com
5. Anton Quni	044 113 441	aquni@hotmail.com
6. Mimoza Kusari Lila	044 540 018	mimikusari@gmail.com
7. Kujtim Shala	045 155 505	kujtimshala@yahoo.com
8. Ilir Deda	044 899 166	ilir.deda@gmail.com
9. Lutfi Zharku	044 501 896	lutfizharku@hotmail.com
10.Arben Gashi	044 138 747	gashibeni@gmail.com
11.Ramiz Kelmendi	049 125 434	rkelmendi@elkosgroup.com
12.Teuta Rugova	049 150 500	teuta.rugova@hotmail.com
13.Fidan Rekaliu	044 694 444	fidan.rekaliu@hotmail.com
14.Arban Abrashi	049 699 699	arban.abrashi@gmail.com
15.Valentina Bunjaku-	044 177 234	dardanet_gjilan@hotmail.com
16.Ismet Beqiri	044 525 525	ismetbeqiri@live.com
17.Haxhi Avdyli	044 157 129	h_avdyli@hotmail.com
18.Korab Sejdiu	044 470 045	korabsejdiu@hotmail.com
19.Lirije Kajtazi	044 506 108	lkajtazi@hotmail.com
20.Naser Rugova	044 640 162	naserrugova@gmail.com
21.Armend Zemaj	044 450 410	azemaj@hotmail.com
22.Naser Osmani	044 501 777	naser_osmani@hotmail.com
23.Hykmete Bajrami	045 300 351	hykmetebajrami@gmail.com
24.Besa Gaxherri	044 600 355	besa.gaxherri@gmail.com
25.Doruntine Maloku-	045 363 363	doruntine.maloku@gmail.com
26.Mirjeta Kalludra	049 155 155	<a href="mailto:mirjet.kalludra@gmail.com">mirjet.kalludra@gmail.com</a>
27.Imet Rrahmani	045300412	imetrrahmani@hotmail.com

## **SHTOJCA 2 PJESËMARRJA E GDP-LDK NË KOMISIONE PARLAMENTARE**

1. Komisioni për Buxhet dhe Financa
  - Lumir Abdixhiku Kryetar i Komisionit
  - Naser Osmani Anëtar
2. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim
  - Kujtim Shala Anëtar
3. Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit
  - Arben Gashi Anëtar
  - Korab Sejdiu Anëtar
4. Komisioni për Integritime Evropiane
  - Armend Zemaj Nënkryetar i parë i Komisionit
  - Ilir Deda Anëtare
5. Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
  - Vjosa Osmani-Sadriu Kryetare e Komisionit
  - Doruntinë Maloku Anëtar
6. Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Inovacione dhe Ndërmarrësi
  - Valentina Rexhepi Anëtar
  - Fidan Rekaliu Anëtar
7. Administratë Publike, Qeverisje Lokale, Media dhe Zhvillim Rajonal
  - Arban Abrashi Anëtar
  - Imet Rrahmani Anëtar
8. Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri
  - Hykmete Bajrami Anëtar
  - Mimoza Kusari-Lila Anëtar
9. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
  - Haxhi Avdyli Anëtar
  - Naser Rugova Anëtar
10. Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor
  - Besa Gaxherri Nënkryetare e parë e Komisionit
  - Lutfi Zharku Anëtar

11.Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

- Ismet Beqiri Anëtar
- Ramiz Kelmendi Anëtar

12.Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjensionit Kosovar për Inteligjencë

- Anton Quni Anëtar
- Teuta Rugova Anëtare

13.Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

- Driton Selmanaj Kryetar i Komisionit
- Avdullah Hoti Anëtar

14.Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione

- Lirije Kajtazi Nënkryetare e parë e Komisionit
- Mirjeta Kalludra Anëtare

### **SHTOJCA 3 STAFI MBËSHTETËS I GP-LDK**

***Dr. Ardita Dushi***

Menaxhere e Zyrës së Grupi Parlamentar dhe Zyrtare për Medie

E-mail : [ardita.dushi@assembly-kosova.org](mailto:ardita.dushi@assembly-kosova.org)

Tel: 045 300 323

***Nexhmije Berisha***

Asistente administrativ për deputetë

E-mail: [grupi.ldk@assembly-kosova.org](mailto:grupi.ldk@assembly-kosova.org)

Tel : 044 664 539

***Mirlinda Zhushi***

Asistente administrative për deputetë

Email : [grupi.ldk@assembly-kosova.org](mailto:grupi.ldk@assembly-kosova.org)

Tel : 044 704 446

***Shpëtim Haziri***

Asistent administrativ për deputetë dhe administrator i TI-së

E-mail: [shpetimhaziri@gmail.com](mailto:shpetimhaziri@gmail.com)

Tel : 044 632 727

***Marigona Berisha***

Asistente administrative e Kryetarit të Grupit Parlamentar

E-mail: [marigona.berisha@assembly-kosova.org](mailto:marigona.berisha@assembly-kosova.org)

Tel: 045 206 221